



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:225286
Datë: 08.10.2024
Numri i dokumentit: 06264938

C-IV-13-2784

Ankuesi

H I fshati M, Gjilan.

Përfaqësuar nga M I (bashkëshortja), fshati M, Gjilan.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Driton Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Sylejman Shumolli, me 03 tetor 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** ankesa si e pabazuar dhe **VËRTETOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit GJI037-1375, datë 11 shtator 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.
- II. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesin.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 01 nëntor 2014, ankuesja (bashkëshortja e ankuesit) dorëzoi në Dhomën e Posaçme, një ankesë kundër Vendimit nr. GJI037-1375, datë 11 shtator 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensimin e kontributeve pensionale në shumë prej 1,636.80 € për periudhën 2002 – 2010 nga NSH NHNI “Morava e Binçës” (*në likuidim*). Ankuesi pohoi se AKP-ja me rastin e nxjerrjes së vendimit në fjalë, nuk ka vepruar drejtë, pasi që ankuesi i ka plotësuar kushtet e parapara ligjore për dëmshpërblimin në fjalë, pasi që i njëjti ka qenë punëtor shumëvjeçar i kësaj ndërmarrje dhe se me rastin e nxjerrjes së vendimit në fjalë nuk është bërë shqyrtimi i drejtë dhe i detajuar i dokumentacionit të prezantuar dhe gjithashtu nuk bën ndonjë lidhje e thuktë logjike, sepse nga analizimi dhe vlerësimi jonë del se me rastin e marrjes së vendimit nuk janë analizuar dhe studiuar mirë të gjitha faktet dhe rrethanat e

prezantuara në kërkesën në fjalë. E kemi parasysh faktin se AKP-ja në vendimin e atakuar përkatësisht në pjesën e arsytimit të vendimit në paragrafin e dytë të vendimit ka cekur se kërkesën për kompensimin e dëmshpërblimit nuk e ka nënshkruar vet H I i cili ka vdekur por të njëjtën e ka nënshkruar bashkëshortja e tij M I, pa patur ndonjë akt formal përfaqësimi. Në rastin konkret vlerësojmë se çështja e ushtrimit të kërkesës, nuk është çështje që duhet diskutuar, por duhet vlerësuar pretendimet e kërkesës, sepse çështja e legjitimitetit mund të rregullohet më pastaj dhe të shpallet trashëgimtari, por bashkëshortja në rastin konkret ka ushtruar vetëm sa për ta zënë afatin dhe në cilësinë e dëshmitarit potencial. Arsyetimi tjetër i cili sipas AL ka qenë “vendimtar dhe bazë e mjaftueshme” për t’ia refuzuar si të pabazuar kërkesën e H I, është shumë i pabazuar në ligj, sepse nuk është analizuar objekt i kërkesës në fjalë, sepse i njëjti ka kërkuar kompensimin për kontributet pensionale që është dashur ndërmarrja t’i paguaj të njëjtit në ATK e të cilat ia ka ndaluar në burim dhe se i njëjti gjatë gjithë kohës ka kërkuar pagesën në fjalë nga ndërmarrja por në formë verbale dhe në bashkëbisedim – kontakt të vazhdueshëm me menaxhmentin e ndërmarrjes. Nga të gjitha këto që u thanë më lartë, shihet shumë kjo që ankuesi – H I në këtë rast është dëmtuar në masë të madhe nga veprimet e pandërgjegjshme dhe jo korrekt e jo profesionale të drejtuesve përkatësisht menaxhmentit të atëhershëm të ndërmarrjes. Ankuesja (bashkëshortja e ankuesit H I) i propozon gjykatës që ta aprovoj si të bazuar ankesën e tij dhe të njëjtit t’i paguhet kompensimi për kontribute pensionale në vlerë prej 1,636.80 €. Në mbështetje të ankesës ka bashkangjitur vetëm vendimin e kundërshtuar.

Me 09 tetor 2018, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se i kundërshton të gjitha pretendimet e të paditurës në padinë e saj, duke i konsideruar si të pabazura në ligj dhe si e tillë duhet të refuzohet. Padia e paditëses nuk përmban bazën ligjore dhe asnjë listë të provave mbi të cilën do ta mbështeste propozimin e saj, andaj propozimi i saj nuk i përmban të gjitha elementet që parashihen me nenin 27 pika 2.4 të Shtojcës së Ligjit nr.04/L-033 për DHPGJS si dhe nenit 253 të LPK-së Nr. 03/L-006. Paditësja nuk ka prezantuar fakte në kuptim të nenit 7 të LPK, ku theksohet se: *“Palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Në procedurën e likuidimit paditësja, kishte parashtruar kërkesë me datë 18 korrik 2013 për kompensimin e kontributeve pensionale të bashkëshortit (tani më të ndjerë) nga e paditura NSH “Morava e Binçës” (në likuidim), në vlerë prej 1,636.80 €. AL me datë 11 shtator 2013, ka vendosur për refuzimin e kërkesës së H I më vendimin ne. GJI037-1375. Agjencia mbështet vendimin e AL mbi bazën e arsytimit të refuzimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 37.9.2 të Shtojcës së Ligjit Nr.04/L-034 për AKP-në *“përveç bazave tjera për kundërshtim të kërkesës, AL gjithashtu ka të drejtë, pa kufizime që të kundërshtojë një kërkesë tërësisht apo pjesërisht bazuar në faktin që kërkesa është e përmbushur në mënyra të tjera”*. E paditura i propozon gjykatës që të hedhet poshtë si e pabazuar në ligj ankesa e ankueses dhe të refuzohet si e pabazuar ankesa e saj si dhe të vërtetohet vendimi i AL-së.

Me 18 tetor 2018, mbrojtja e të paditurës iu dorëzua ankueses, por asnjë përgjigje nuk u dorëzua.

Për detaje të tjera, referimi mund të bëhet në dosjen e lëndës.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar dhe vërtetohet vendimi i AL si i drejt dhe i bazuar në ligj.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrirat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Nga shkresat e lëndës gjykata gjen se ankuesja ka kundërshtuar vendimin e AL nr. GJI037-1375, datë 11 shtator 2013, me të cilin vendim ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensim të kontributeve pensionale në shumë prej 1,636.80 € për periudhën 2002 – 2010 nga NSH NHNI “Morava e Binçës” (*në likuidim*).

Neni 37.9.9.2 i Shtojcës së Ligjit 04/L-034 për AKP-në, parasheh:

“Përveç bazave tjera për kundërshtim të kërkesës Autoriteti i Likuidimit gjithashtu ka të drejtë, pa kufizime që të kundërshtojë një kërkesë tërësisht apo pjesërisht bazuar në faktin që kërkesa është përmbushur në mënyra tjera”

Gjykata konsideron se AL drejt ka vendosur kur ka refuzuar kërkesën e ankuesit për kompensim të kontributeve pensionale në shumë prej 1,636.80 € për periudhën 2002 – 2010 nga NSH NHNI “Morava e Binçës” (*në likuidim*), në kuptim të dispozitës së lartcekur. Siç dihet, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) është autoriteti i vetëm i autorizuar për mbledhjen e tatimeve dhe kontributeve pensionale në Republikën e Kosovës, andaj një zgjidhje tjetër nuk ishte e mundur. Kjo detyrë e ATK-së buron drejtpërdrejtë nga legjislacioni fiskal dhe tatimor dhe rrjedhimisht ATK kujdeset zyrtarisht për përmbushjen e detyrimeve të tilla nga të gjithë punëdhënësit pa dallim në Republikën e Kosovës. Prandaj, kërkesa e ankuesit me të drejtë është refuzuar, pasi e njëjta mund të jetë përmbushur në mënyra tjera.

Për më tepër, edhe nën supozimin se kërkesa e tij nuk është përmbushur në mënyra tjera, ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi relevante në mbështetje të kërkesës së tij për kompensim të kontributeve pensionale të papaguara. Dëshmia e vetme e dorëzuar në këtë rast nga ankuesi është vendimi i kundërshtuar, dokument i cili nuk mund të konsiderohet si një dëshmi relevante për themelësinë e kërkesës së ankuesit për kompensim të kontributeve pensionale të papaguara. Për më tepër, ankuesja ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së saj edhe pas dorëzimit të mbrojtjes së të paditurës për përgjigje.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palëve por gjen se të njëjtat nuk kanë efekt për të vendosur ndryshe përveç lënies në fuqi të vendimit të kundërshtuar, prandaj si të tilla dhe refuzohen.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjyqimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli
Gjyqtar